

## 7.5 FSHIRJA E FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE

Nga regjistrimi mund të fshini fushat dhe nënfusha. Mund të përzgjidhni disa fusha *të njëjta*.


### Procedura

1. Klikoni fushën ose nënfushën.
2. Përzgjidhni metodën **Redaktimi / Fshi fushën**.

Fusha e klikuar (ose disa fusha të njëjta) me nënfushat përkatëse fshihet dhe ruhet në kujtesën e fragmenteve të fushave.



Këshillë:

Fushën e fundit të fshirë (ose disa fusha të njëjta) mund ta ktheni në regjistrim duke klikuar në ikonën .

### Mundësitë...

Fushën (ose disa fusha të njëjta) mund ta fshini edhe duke shtypur në tastet <Ctrl> + <F7>, përkatësisht tastin <Delete>.

Në redaktuesin e regjistrimit mund të fshini edhe nënfushat.

### Procedura

1. Klikoni nënfushën. Brenda një fushe mund të përzgjedhni disa nënfusha *të ndryshme*.
2. Përzgjidhni metodën **Redaktimi / Fshi nënfushën**.

Nënfusha e përzgjedhur (ose disa nënfusha të përzgjedhura) fshihet dhe ruhet në kujtesën e fragmenteve të nënfushave.




Shënim:

*Kur të fshini nënfushën e fundit në fushën e dëshiruar, fshihet e tërë fusha.*



Këshillë:

Nënfushën e fshirë së fundi (ose disa nënfusha) mund ta ktheni në regjistrim duke klikuar në ikonën .

### Mundësitë...

Nënfushën ose disa nënfusha mund t'i fshini edhe duke shtypur tastet <Ctrl> + <F9>, përkatësisht tastin <Delete>.